

Hartografimi me pjesëmarrje

Unifikimi i kadastrës së tokës në Komunën Topojë nëpërmjet hartografimit me pjesëmarrje dhe ndikimi në zhvillim rural

Përvojë nga fshati Seman, komuna Topojë-Seman, Qarku Fier

Ky aktivitet mishëron qasjen dhe strategjinë e Projektit të ILC lidhur me rritjen e kapaciteteve për planifikimin më të mirë të pyjeve, kullotave dhe tokës. Nëpërmjet këtij projekti, FKPKK ka nisur procesin e pilotimit të unifikimit të kadastrës së tokës nëpërmjet një qasje pjesëmarrëse. Objektivi i përgjithshëm i unifikimit të kadastrës është përmirësimi cilësor i planifikimit dhe menaxhimit të tokës nga njësitë vendore, nëpërmjet një kadastrë dixhitale unike për të gjitha kategoritë e përdorimit të tokës.

Ky proces i ndarë në dy faza konsiston në indentifikimin dhe hartografimin me pjesëmarrje të sipërfaqes pyjore e kullosore të fshatit. Gjatë kësaj faze, banorët së bashku përcaktojnë territorin e tyre të pyjeve që përdorin, qëllimet dhe strategjitë e menaxhimit nëpërmjet një procesi me pjesëmarrje. Përfshirja e komunitetit vendor me përvojën e tyre përmirëson saktësinë e të dhënave të grumbulluara. Po ashtu, siguron unitet në veprimin e komunitetit për pyjet dhe kullotat e përbashkëta, çka rrjedhimisht reflektohet në përmirësimin e menaxhimit të këtyre burimeve nëpërmjet një planifikimi me pjesëmarrje që paraqet nevojat e komunitetit.


Dhe faza apo hapi tjetër është grumbullimi dhe shqyrtimi i çdo materiali tjetër hartografik dhe dokumentar me stafin përgjegjës të njësisë së qeverisjes vendore për unifikimin e kadastrës së kategorive të ndryshme të përdorimit të tokës (tokë pyjore, bujqësore, zonë urbane), si dhe rekoinicioni në terren dhe korrektimi i mospërputhjeve eventuale me komisionin e fshatit.

Metodologjia e përdorur

Hartografimi me pjesëmarrje i pyjeve dhe kullotave të fshatit

Procesi është realizuar me pjesëmarrjen e komunitetit dhe janë ndjekur veprimet e mëposhtme:

- Ngritja e komisionit, të përbërë nga burra dhe gra të fshatit, ekspertë të njësisë vendore



Partnerët në zbatim

Partnerët kryesorë ishin:

- Komuna Topojë-Seman me stafin e saj;
- Komuniteti i fshatit Seman;
- Komisioni i fshatit Seman;
- Federata rajonale e pyjeve FIER;
- Stafi i FKPKK.

Rezultatet e arritura

- U identifikua dhe hartua me pjesëmarrje sipërfaqja prej **216.2 ha** e pyllit dhe kullotave të fshatit Seman.
- U hartua plani i menaxhimit të pyllit të fshatit Seman.
- U krijua kadastra e unifikuar pilot për kategoritë e ndryshme të përdorimit të tokës.
- U përmirësuan njohuritë teknike të stafit të komunës për hartografinë me pjesëmarrje, planifikimin e përdorimit të pyllit dhe tokës.

Qëndrueshmëria e procesit

- Marrja e të drejtës së pronësisë është një mundësi kyçe për zhvillimin e mëtejshëm në zonat rurale të Shqipërisë. Përdorues në fshatrat e tjera të komunës Topojë-Seman kanë shfaqur interes për këtë proces.
- Lidhja e kontratave u jep përdoruesve mundësinë të aplikojnë për grante apo kredi sepse kanë dokumenta ligjore. Kjo ndikon në përmirësimin e gjendjes së pyjeve, në plotësimin e nevojave të tyre dhe përmirëson jetesën në këto zona të varfëra. Për më tepër në disa vende fermerët mund të përfitojnë nga skema e subvencionit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit për kultivimin e BMET, Arrorëve.

Decentralizimi është në politikat e Qeverisë Shqiptare. NJQV-të duhet të kujdesen për tokat dhe pyjet e tyre. Dhënia e tyre në pronësi e përdorim tek përdoruesit tradicionalë minimizon rastet e zjarreve në pyje dhe ul rrezikun e erozionit. Menaxhimi i duhur i pyjeve gjeneron më shumë të ardhura për fermerët dhe gjithë komunitetin.